KRONIKË E ZEZË

Arrestohet i dyshuari për vrasjen në Podujevë



Policia e Kosovës ka arrestuar një të dyshuar për vrasjen e së hënës në Podujevë.

Autoritetet policore i thanë KOHËS se i arrestuari me inicialet A.S., është ndaluar me urdhër të prokurorit.

Policia e Kosovës njoftoi në raportin 24-orësh se ka kryer bastisje në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të të arrestuarit, me ç'rast ka konfiskuar një pistoletë me katër karikatorë e 62 fishekë, një pushkë gjuetie me dylbi, 20 fishekë, dy antiplumba dhe një veturë me targa të huaja.

"Në lidhje me rastin është arrestuar një i dyshuar mashkull kosovar, nën dyshimin e bazuar se i njëjti është i përfshirë në kryerjen e veprës së lartcekur bashkë me të dyshuarin i cili dyshohet se kishte kryer vrasjen dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes", thuhet në njoftimin e Policisë.

Rasti është iniciuar si "vrasje e rëndë në bashkëkryerje".

KOHA ka mësuar se një i dyshuar tjetër është në arrati, e në moshë më i ri se i arrestuari. Dy të dyshuarit thuhet se kanë qenë në kontakt para kryerjes së veprës penale.

Mesditën e së hënës është vrarë me armë zjarri një person në sheshin "Zahir Pajaziti", e një tjetër është plagosur.

KOHA ka mësuar se e plagosura është bashkëshortja e viktimës. Sipas dëshmitarëve, në momentin kritik viktimat kanë qenë me djalin e tyre rreth 4 vjeç.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#VRASJA NE PODUJEVE #VRASJE

Nga Nexhat Tovërlani

12 shtator 2023, 08:58

Shpërndaje në

Dogana sekuestron 40 mijë euro mallra të kontrabanduara në Prishtinë

Parandalohen dy raste të kontrabandës me mallra nga Serbia

Ikë një i burgosur nga Dubrava

Sulmohen policët në Gjilan, arrestohen dy persona

Digjen disa varreza në Ferizaj

Lindin dyshime për prejardhjen e viktimave në Greqi

Zjarr në "Sofali" të Prishtinës, zjarrfiksët në vendin e ngjarjes

Taboola Feed

Intervistohet një serb 78-vjeçar, ndezi zjarr në varrezat ortodokse serbe në Ferizaj

Policia e Kosovës ka bërë të ditur se të hënën është ndaluar një 78-vjeçar shtetas i Serbisë, nën dyshimin se kishte ndezur zjarr në varrezat ortodokse serbe në Ferizaj. B.G. ka bërë t...

Kohanet

Sulmohen policët në Gjilan, arrestohen dy persona

Policia e Kosovës i ka arrestuar dy persona në Gjilan, të dyshuar për posedim të substancës narkotike. Ndërsa gjatë arrestimit, të dyshuarit kanë rezistuar dhe kanë sulmuar një zyrtar ...

Kohanet

Policia e Kosovës arreston shtetasin serb të kërkuar me urdhër-arrest ndërkombëtar

Një shtetas serb i kërkuar me urdhër-arrest ndërkombëtar, është arrestuar të hënën nga Policia e Kosovës. Siç është bërë e ditur në njoftimin e Policisë, arrestimi i të dyshuarit ...

Kohanet

Vriten gjashtë shqiptarë me armë zjarri në Greqi

Gjashtë persona mbetën të vrarë nga të shtënat me armë zjarri që ndodhën pasditen e sotme në zonën e Artemis në Athinë, tha policia. Sipas informacioneve të para bëhet fjalë për një ...

Kohanet

TË TJERA

Vrasja e gjashtë shqiptarëve në Greqi, mësohet se ata u qëlluan me mbi 20 plumba

Policia e Kosovës arreston shtetasin serb të kërkuar me urdhër-arrest ndërkombëtar

Intervistohet një serb 78-vjeçar, ndezi zjarr në varrezat ortodokse serbe në Ferizaj

Kapen autopjesë të kontrabanduara në Vërmicë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!